AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Mars 2024

19.04.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin mars 2024.

Deficit tregtar prej 3,0% në muajin mars 2024, krahasuar me muajin mars 2023

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 3,0% në muajin mars 2024, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 439,7 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 426,8 milion Euro në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 15,5%.

Eksporti i mallrave në muajin mars 2024 kishte vlerën 80,5 milion Euro, ndërsa importi 520,3 milion Euro, që është një rënie prej (-1,5%) për eksport, si dhe një rritje prej 2,3% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 25,8% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14,1% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9,7% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9,1% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar; 6.7 % e përbëjnë kategoria perlë, gurë të çmuar, metale të çmuara, etj.; 6.1% e përbëjnë tekstili dhe artikujt e tekstilit; etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 12,9% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12,6% e përbëjnë produktet minerale; 11,3% e përbëjnë mjetet e transportit; 11,2% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10,8% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	Mars - 2023		Mars - 2024	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**81 776**	**100,0**	**80 538**	**100,0**
27 vendet e BE_së	28 058	34,3	30 849	38,3
Cefta	32 037	39,2	32 410	40,2
Të tjera	21 681	26,5	17 279	21,5
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**508 580**	**100,0**	**520 280**	**100,0**
27 vendet e BE_së	228 137	44,9	251 898	48,4
Cefta	92 557	18,2	67 186	12,9
Të tjera	187 886	37	201 196	38,7

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 30,8 milion Euro, ose rreth 38,3% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 9,9%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (11,7%), Austria (6,9%), Italia (4,5%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 251,9 milion Euro, ose 48,4% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 10,4%. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (15,3%), Italia (4,9%), Greqia (4,8%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 32,4 milion Euro, ose 40,2% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 1.2%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (15,9%), Shqipëria (13,3%), Serbia (5,1%), Mali i Zi (4,5%).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 67,2 milion Euro, ose 12,9% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-27,4%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (5,4%), Maqedonia e Veriut (4,5%), Serbia (1,8%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 17,3 milion Euro, ose 21,5%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (9,1%) dhe SHBA (3,4%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 201,2 milion Euro, ose 38,7%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (18,6%) dhe Kina (8,7%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin mars 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade